



ITALIAN TRADE AGENCY

Zyra Tiranë

Objekti: NJOFTIM PËR PROCEDURË PËRZGJEDHJEJE PERSONELI VENDAS PËR T'U PUNËSUAR ME KONTRATË ME AFAT TË CAKTUAR PRANË DESK-UT ICE – AGJENCIA VLORË

Drejtori i Zyrës së ICE - Agjencia e Tiranës, nga i cili varet Desku promocional ICE i Vlorës, Dr. Francesca Mondello:

DUKE QENË SE

Dekreti i 7 shtatorit 2015 nr. 18549/21178 me të cilin miratohet Statuti i ICE - Agjencisë për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e firmave italiane dhe në veçanti neni 12 paragrafi 3 në të cilin thuhet se Agjencia ICE vepron jashtë vendit përmes njërive të saj operative të vendosura në kuadër të Përfaqësive Diplomatike dhe konsullore;

DUKE QENË SE

Dokumenti autorizues i Drejtorit të Zyrës së Partneriteti Industrial dhe Marrëdhënieve me Organizmat Ndërkombëtare, prot. n. 0136625/21 datë 02/12/2021, i cili strukturon nismën promovuese "VEPRIMTARI BASHKËPUNIMI NË BALLKAN" (Shqipëri, 01/12/21 – 30/09/24), parashikon ngritjen e një Desk ICE me kohëzgjatje dy vjeçare pranë Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË

neni. 14 paragrafi 4 i statutit të lartpërmendur, i cili thotë se Agjencia ICE mund të marrë personelin e punësuar në nivel lokal për nevojat e njërive operative, në përputhje me dispozitat e nenit 14, paragrafi 25 të Ligjit për krijimin e Agjencisë ICE, marrëdhëniet e punës së të cilëve përcaktohen nga rregullat dhe praktikat lokale;

NJOFTON SE

është hapur procedura e përzgjedhjes për rekrutimin e një personi me detyra të marketingut dhe asistent analisti të tregut, me një periudhë prove prej 3 muajsh, për një afat të caktuar. Vendi i punës do të jetë Desk-u ICE në Vlorë. Paga bruto mujore do të jetë e barabartë me 655.57 euro. Ju informojmë se ICE nuk njeh/rimburson shpenzimet për të mbërritur në vendin e punës, që do të jetë pranë Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë.

Procedura e përzgjedhjes do të kryhet në Tiranë.

1. Kërkesat, kualifikimet dhe eksperiencia e kërkuar për pranim

Mund të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes kandidatët që plotësojnë kushtet, kanë kualifikimet dhe eksperiencën e kërkuar në këtë njoftim:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- Kanë një diplomë trevjeçare ose specializim, të preferueshme në Ekonomi, Drejtesi, Shkenca Politike;
- Përvojë të mëparshme pune me shoqëritë ose institucionet italiane, vendase ose të huaja në Shqipëri, mundësisht në sektorin e promovimit, marketingut dhe tregtimit të produkteve dhe shërbimeve dhe në përdorimin e fondeve evropiane. Eksperienca e mëparshme me entet dhe/ose shoqëritë italiane, është e preferueshme;
- Njohuri të mira të kontekstit ekonomik të Shqipërisë së Jugut dhe në veçanti të Zonës së Vlorës, si edhe të rrjetit të bashkëpunëtorëve institucionalë e privatë me interes për shoqëritë italiane;
- Kualifikimet profesionale përbëjnë titull preferencial nëse janë të konsiderueshme;
- Përveç gjuhës shqipe, kanë njohuri të mira të gjuhës italiane. Një njohje e mirë e gjuhës angleze është e preferueshme;
- Njohuri të mira të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve kryesore operative;
- Te kete vendbanim në Shqipëri të paktën dy vitet e fundit;
- Nuk ka dënime penale dhe nuk është nën hetim në Shqipëri, Itali dhe shtete të tjera.

2. Përshkrimi i detyrave

Detyra e Desk-ut do të jetë intensifikimi i mbledhjes, studimit dhe përpunimit të informacionit strategjik dhe operacional në Shqipëri, me fokus të veçantë në programet kombëtare të investimeve në bregdetin jugor (zhvillimi ekonomik dhe turistik i zonave të identifikuar, duke e përqendruar vëmendjen tek infrastruktura përfshirë atë detare, akomodimi/mikpritja dhe vendet me interes të veçantë).

Desk-u do të përfaqësojë një antenë në zonën e Vlorës dhe Shqipërisë së Jugut, duke promovuar pjesëmarrjen e operatorëve italianë në programet e zhvillimit, nëpërmjet marrëdhënieve me autoritetet vendore përgjegjëse dhe/ose të përfshira në planifikimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit (si në kuadrin e parazgjerimit, edhe në atë të bashkëpunimit në zhvillimin bilateral dhe multilateral), edhe nëpërmjet përdorimit të fondeve dhe instrumenteve të tjera financiare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pozicioni parashikon që Asistent Analist i Tregut kryen, nën drejtimin e Drejtorit të ICE Tiranës, detyrat e mëposhtme kryesore, por pa u kufizuar në to, në fushën e promovimit të "Made in Italy" dhe të ndihmes së marketingut për shoqëritë italiane të interesuara për eksport dhe investime në Shqipëri, si dhe për shoqëritë e interesuara për projekte pune nëpërmjet përdorimit të fondeve evropiane.

A. Asistencë për shoqëritë

- Analiza të tregut shqiptar, me fokus të veçantë në zonën e Vlorës dhe rajonet jugore;
- Identifikimi dhe analiza e sektorëve më premtues për shoqëritë italiane;
- Përditësimi dhe përgatitja e *mailing* për operatorët shqiptarë dhe italianë;
- Hartimi i analizave të tregut dhe raporteve sektoriale për shoqëritë dhe shoqatat italiane;
- Identifikimi dhe përzgjedhja e palëve për shoqëritë italiane aktive në sektorë të ndryshëm merceologjik;
- Hartimi i propozimeve të asistencës së personalizuar dhe kujdesi për aktivitetet e lidhura me to;
- Organizim i aktiviteteve promovuese si panaire, seminare, workshop, business to business (B2B), takime, kurse trajnimi, misione operatorësh/gazetarësh, etj.;
- Analizë, mbikeqyrje dhe shpërndarje e informacionit në lidhje me mundësitë tregtare,

- financimet kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare, thirrjet për tender, etj.;
- Hartim materialesh për t'u publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe në social media-t e ndryshme (Twitter, LinkedIn, Instagram, etj.);
- Mbështetje për Analistët e Tregut dhe Drejtorin e Zyrës kompetente ICE, në përgatitjen e dokumentacionit për institucionet italiane, në planifikimin e aktiviteteve promovuese dhe në administrimin e kontakteve me administratat publike dhe shoqatat e bizneseve.

B. Administrative

- Përditësimi i database (shoqëritë italiane dhe vendase);
- Regjistrimi i të dhënave administrative, arkivimi i dokumentave, faturimi i shërbimeve, etj;
- Përgatitja e dokumentave të kërkuara në marrëdhëniet me shoqëritë;
- Administrim kontabël / administrativ i iniciativave promovuese të kompetencës;
- Aktivitetet e Sekretarit kur kërkohet;
- Mbështetje për zyrën ICE përgjegjëse edhe në lidhje me detyra të tjera që do të caktohen nga Drejtori.

Asistentit Analist Tregu mund t'i kërkohet, për detyrat e kryera dhe për kryerjen e punës së tij të shkojë në mision brenda dhe jashtë Shqipërisë.

3. Paraqitja e Kërkesave për pranim

Kandidatët duhet të paraqesin kandidaturën e tyre duke përdorur Formularin bashkëlidhur këtij njoftimi. Ata do të duhet të dërgojnë një Curriculum Vitae (CV) në formatin Evropian, duke pasur kujdes në specifikimin e kualifikimeve dhe eksperiencave të fituara. CV-ja e shkruar në italisht duhet të shoqërohet me një kopje të titullit të studimit të fituar. Kandidatët duhet gjithashtu të dërgojnë një kopje të kartës së identitetit të vlefshme dhe deklaratën zëvendësuese me të cilën tregojnë vendbanimin e tyre, specifikojnë shtetësitë që mbajnë dhe vërtetojnë mungesën e ndonjë dënimi penal dhe/apo hetimi në vijim. Kandidatët në momentin e dërgimit të kandidaturës duhet të specifikojnë me shkrim se autorizojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale që do të përpunohen ekskluzivisht për qëllime të procedurës së përzgjedhjes.

Dokumentacioni duhet të dërgohet vetem nëpërmjet e-mail Zyrës ICE – Agjencia të Tiranës në adresën e mëposhtme të postës elektronike: selezione.desk.valona@ice.it brenda orës 12.00 të datës 7 mars 2022, duke shkruar në Objektivin e mesazhit të dërguar fjalën "Selezione Desk Valona" ("Përzgjedhje Desk Vlora").

4. Përrjashtimi nga procedurat e përzgjedhjes

Sa më poshtë sjell përjashtimin nga testet e përzgjedhjes:

- Aplikimet pa një nënshkrim autografik dhe pa dokumentat bashkëlidhur të përmendura më lart;
- Aplikimet që nuk tregojnë zotërimin e të gjitha kërkesave të përcaktuara në pikën 1 (Kërkesat, kualifikimet dhe eksperiencia e kërkuar për pranim) më sipër.;
- Aplikimet të paraqitura përtej afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij njoftimi;
- Aplikimet jo të plota sipas asaj që përshkruhet në pikën 3 të këtij njoftimi.

5. Vlerësimi i kualifikimeve dhe intervistës

Zyra ICE - Agjencia e Tiranës, nepermjet një Komisioni të krijuar posaçërisht, do të ekzaminojë aplikimet e marra duke pranuar vetëm ato që plotesojnë kërkesat e përgjithshme të përmendura në pikën 1. *Kërkesat, kualifikimet dhe eksperiencia e kërkuar për pranim.*

Komisioni do të vlerësojë më pas cilësinë e kualifikimeve fituese (notat, lëndët, diplomat e mundshme pasuniversitare), eksperiencën profesionale (organi ku është realizuar eksperiencia, lloji i veprimtarisë, referencat, kohëzgjatja, etj.) dhe do të krijojë listën e kandidatëve të pranuar në intervistë bazuar në arritjen e një rezultati minimal pikësh prej 18/30.

Vlerësimi të CV-së do t'i jepet një vlerësim maksimal prej 30 pikësh, nga të cilat:

- titujve të studimit një rezultat maksimal prej 10 pikësh;
- eksperiencës së mëparshme të punës një vlerësim maksimal prej 20 pikësh.

Rezultati i këtij vlerësimi do t'u komunikohet të gjithë kandidatëve që do konsiderohen të kualifikuar.

Thirrja për të kryer provimin, të cilin parashikojmë ta zhvillojmë në muajin Mars 2022, do të dërgohet nepermjet postës elektronike në adresën e deklaruar nga konkurruesi në momentin e aplikimit. Provimet, të cilat do të zhvillohen në Zyrën e ICE në Tiranë, do të ndahen në një provim me gojë dhe një test me shkrim/ praktikë. Kandidatët nuk kanë të drejtë rimbursimi të shpenzimeve të kryera për të marrë pjesë në provim.

Provimit me gojë do t'i jepet një notë maksimale prej 40 pikësh.

Testit me shkrim/praktikës do t'i jepet një rezultat maksimal prej 30 pikësh.

Provimi me gojë do të konsistojë në një intervistë, në italisht dhe shqip, me qëllim përcaktimin e përshtatshmërisë për të kryer funksionet që lidhen me pozicionin e punës dhe një bisede në italisht, mbi tema të situatës aktuale ekonomike shqiptare dhe një përkthim të shkurtër, pa përdorimin e fjalorit, nga shqipja në italisht.

Testi me shkrim do të përbëhet nga përkthime të shkruara, pa përdorimin e fjalorit, nga italishtja në shqip dhe anasjelltas të artikujve ekonomikë të shfaqur në shtypin lokal, nxjerrje dhe përpunim të të dhënave ekonomike dhe statistikore dhe simulim përgjigje, në italisht, të një kërkesë për informacion nga një shoqëri italiane.

Testi praktik do të finalizohet për të siguruar njohjen e instrumenteve kryesore informatike dhe aplikacioneve përkatëse të lidhura me to.

6. Lista përfundimtare

Lista do të formulohet nga Komisioni Vlerësues menjëherë pas përfundimit të fazës së provimit. Do të konsiderohen të pranueshëm për renditjen në listën përfundimtare kandidatët që kanë marrë pikët minimale prej 60/100 dhe do të përzgjidhet kandidati që ka grumbulluar totalin më të lartë të pikëve.

Rezultati relativ i pikëve do të caktohet me vendim unanim të Komisionit Vlerësues.

Drejtori i Zyrës së ICE - Agjencia e Tiranës, përgjegjës për Desk-un e ICE – Agjencia Vlorë, pasi ka njohur rregullsinë e procedurës së përzgjedhjes, miraton listën për veprimet e mëtejshme. Lista është menjëherë efektive dhe mund të përdoret për punësim me afat të caktuar në Desk-un e ICE – Agjencia Vlorë në harkun kohor të vlefshmërisë së listës, që është dy vjet nga data e miratimit të të

njëjtës listë. Rezultati i përzgjedhjes dhe hyrja në listën e renditjes do t'i njoftohet kandidatëve nëpërmjet postës elektronike. Theksohet se përzgjedhja nuk përbën garanci për dhënien e vendit të punës.

7. Krijimi i marrëdhënies së punës

Marrëdhënia e punës do të krijohet përmes lidhjes së një kontrate me afat të caktuar të kushtëzuar nga kalimi i periudhës 3-mujore të provës. Kontrata mund të hartohet vetëm pas marrjes me sukses të autorizimit të sigurisë nga Ambasada e Italisë në Tiranë. Nëse Përfaqësimi diplomatik, pasi ka bërë kontrollet e nevojshme, nuk lejon lëshimin e lejes së sigurisë, kontrata nuk mund të lidhet dhe kandidati në fjalë nuk do të jetë pjesë e stafit të Desk-ut ICE - Agjencia Vlorë.

Kandidati që rezulton fitues do të duhet të paraqesë brenda 15 ditëve nga data e komunikimit të fitimit të pozicionit nga ICE - Agjencia, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Raport mjekësor për vërtetimin e gjendjes shëndetësore/afëtësisë në punë, i lëshuar nga institucionet mjekësore private dhe/ose publike.
- Kopje, të njehsuar nga noter i licensuar, të titujve të studimit (përfshirë notat) sipas *Curriculum Vitae*-s të nënshkruar nga kandidati.

Nëse kontrollet pasuese zbulojnë përmbajtje të pavërteta të vetëdeklarimeve, pala e interesuar do të përballet me sanksionet penale të parashikuara në nenin 76 të Dekretit të sipërpërmendur të Presidentit. n. 445/2000, duke u pushuar menjëherë nga detyra dhe nga çdo përfitim tjetër i marrë eventualisht në bazë të deklaratës së pavërtetë.

8. Përpunimi i të dhënave personale

Dorëzimi i aplikimeve për pjesëmarrje në përzgjedhje nga kandidatët nënkupton dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë të dhënat sensitive, në kujdesin e personelit të caktuar për kujdesin dhe ruajtjen e aplikimeve dhe përdorimin e tyre në funksion të zhvillimit të procedurave të konkurrimit.

9. Klauzolë shteruese

Zyra ICE - Agjencia e Tiranës rezervon të drejtën të anulojë këtë njoftim për arsye serioze të mundësive të vlerësuara si të tilla në mënyrë diskrecionale. Gjithashtu rezervon të drejtën të mos vazhdojë me caktimin në detyrë në rast të mungesës së kandidatëve në zotërim të kërkesave të duhura dhe të mungesës së disponibilitetit të burimeve financiare për të mbuluar shpenzimet e emërimit.

10. Kodi i etikës dhe sjelljes

Kandidatët e përzgjedhur duhet të ndjekin Kodin e Etikës dhe Sjelljes së Agjencisë ICE i cili do të jetë pjesë integrale e kontratës.